



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1179 Prot.

Gjirokastër më, 15.07.2025

V E N D I M

Nr. 29 , datë 15 , 07 , 2025

PËR
MIRATIMIN E PROJEKT-RREGULLOREVE TË FAKULTETEVE TË
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Në mbështetje të: neneve 39 dhe 40 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, Nenit 18 dhe nenit 19, të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Rregullores së Përgjithshme të Universitetit neni 27, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi; Duke marrë në shqyrtim projekt-rregulloret e hartuara dhe miratuara në nivel fakulteti dërguar me shkresën nr.66/1, datë 26.06.2025 Fakulteti Ekonomik, me vendim nr.10, datë 14.07.2025 Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, me shkresën 61/1, datë 30.05.2025 Fakulteti i Shkencave të Natyrës; Në funksion të rritjes së transparencës, garantimit të funksionimit të brendshëm sipas parimeve të ligjshmërisë, llogaridhënies dhe efektivitetit administrativ e akademik, Senati Akademik nw mbledhjen e datës 15.07.2025;

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloret e funksionimit të tre fakulteteve të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, të cilat janë hartuar në përputhje me Statutin dhe aktet normative të institucionit dhe janë paraqitur për shqyrtim nga strukturat përkatëse:
 - Rregullorja e Fakultetit Ekonomik;
 - Rregullorja e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
 - Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
2. Rregulloret e sipërcituara përbëjnë kuadrin rregullator për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të fakulteteve përkatëse dhe janë detyruese për të gjitha njësitë akademike dhe administrative në varësi të tyre.

3. Ngarkohen Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe sekretaritë përkatëse për zbatimin e këtyre rregulloreve, si dhe për marrjen e masave për publikimin dhe informimin e stafit dhe studentëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Rregulloret miratohen si pjesë e akteve normative të universitetit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të universitetit.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1180 Prot.

Gjirokastrë më, 15 07 .2025

V E N D I M

Nr . 30 , datë 15 , 07 , 2025

PËR
REDUKTIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË DOKTORATËS PËR PUNONJËSIT E
BRENDSHËM TË UNIVERSITETIT

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, germa "ç" dhe nenit 38, pika 1, germa "k" të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si dhe pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur me miratim të Administratorit të Universitetit, Senati Akademik:

VLERËSOI:

1. Se nisja për herë të parë e programeve të doktoratës në universitet përbën një moment strategjik dhe sfidues për zhvillimin institucional;
2. Se përfshirja e punonjësve të brendshëm në këto programe është një investim afatgjatë për forcimin e kapaciteteve të kërkimit shkencor dhe cilësisë së stafit akademik;
3. Se lehtësimi financiar për këtë kategori përfaqëson një politikë stimuluese, në përputhje me interesin institucional dhe mundësitë buxhetore të universitetit;
4. Se universiteti, në kuadër të autonomisë financiare dhe organizative, ka të drejtë të ndërmarrë masa të tilla nëpërmjet strukturave të tij vendimmarrëse;

VENDOSI:

1. Të miratojë reduktimin e tarifës totale të studimeve të doktoratës për periudhën trevjeçare nga 600, 000 (gjashtë qindë mijë) lekë në 300, 000 (tre qindë mijë) lekë, vetëm për kandidatët që janë punonjës të brendshëm të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Pagesa e tarifës së reduktuar do të kryhet me kështu, të shpërndara gjatë kohëzgjatjes së studimeve, ku kështu i parë, në vlerën 100,000 (një mijë lekë) lekë, duhet të shlyhet brenda një jave nga hyrja në fuqi e vendimit.
3. Ky vendim i Senatit Akademik i nënshtrohet miratimit nga Bordi i Administrimit të Universitetit, si strukturë përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe buxhetor të institucionit.

4. Pas miratimit nga Bordi i Administrimit, ngarkohen Administratori i Universitetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare për ndjekjen dhe zbatimin e tij.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të universitetit.

KRYETARI
PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1181 Prot.

Gjirokastrë më, 15.07.2025

V E N D I M

Nr. 31, datë 15.07, 2025

P Ë R
MIRATIMIN E SHPËRBLIMIT MUJOR PËR ANËTARËT E KOMISIONIT TË
SHKOLLËS DOKTORALE

Në mbështetje të neneve 37 dhe 38 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 18 dhe nenit 19 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Rregullores së Universitetit; Rregullores "Për organizimin e programit të përbashkët të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës në 'Edukimi dhe Shkencat Humane'", të ndryshuar me vendimin nr. 18, datë 28.04.2025; si dhe Urdhrit nr. 41, datë 10.03.2025 të Rektorit, pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur nga Rektorati për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Shkollës Doktorale në mbledhjen e datës 15.07.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shpërblimin mujor në vlerën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për secilin anëtar të Komisionit të Shkollës Doktorale, për angazhimin e tyre periodik dhe të vazhdueshëm në funksione akademike dhe administrative, sipas përcaktimeve të rregullores përkatëse.
2. Shpërblimi do të aplikohet për gjithë periudhën në të cilën zgjat programi i doktoratës, sipas strukturës dhe afateve të përcaktuara në rregulloren përkatëse të studimeve.
3. Shpenzimet për këtë shpërblim do të mbulohen nga të ardhurat e universitetit, në zërin buxhetor "shërbime të ndryshme".
4. Ngarkohen Administratori i Universitetit dhe Drejtorja e Shërbimeve Universitare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO ÇANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 1182 Prot.

Gjirokastrë më, 15.07.2025

V E N D I M

Nr. 32, datë 15, 07, 2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNITIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE DREJTORISË
RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 15.07.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Gjirokastrë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO ÇANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 1183 Prot.

Gjirokastrë më, 15.07.2025

V E N D I M

Nr. 33 , datë 15 , 07 , 2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNITIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE INTERANCIONAL
BLACK SEA UNIVERSITY GEORGIA**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 15.07.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe International Black Sea University Georgia sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHOR ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1230 Prot.

Gjirokastrë më, 25.07.2025

VENDIM

Nr. 34, datë 25, 07, 2025
PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE DHE ZHVILLIMIT NË
PROGRAMIN E PËRBASHKËT DOKTORATURË NË EDUKIM DHE SHKENCA
HUMANE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" PËR VITIN
AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të nenit 37,38, 77 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020, i përditësuar dhe i ndryshuar, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, veçanërisht të përcaktimeve të Shtojcës nr. 4, që lidhet me kuotat në programet e doktoraturës; Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 25.07.2025, pasi shqyrtoi propozimet e Fakultetit të Edukimit Shkencave Shoqërore, relacionet shoqëruese dhe dokumentacionin mbështetës, si dhe pas verifikimit të përmbushjes së kushteve ligjore për personelin akademik të angazhuar si drejtues shkencorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë projektet kërkimore-shkencore dhe zhvillimit në programin e ciklit të tretë të studimeve "Doktoraturë" në Edukim dhe Shkenca Humane për vitin akademik 2025-2026, sipas propozimeve të njësive përgjegjëse dhe kapaciteteve ekzistuese akademike e kërkimore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Drejtuesit shkencorë të angazhuar në programet e doktoraturës janë personel akademik me titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar", të cilët plotësojnë kriteret ligjore për udhëheqje dhe nuk e tejkalojnë kufirin maksimal të lejuar të udhëheqjeve, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015. Ky verifikim është bërë duke marrë parasysh të gjitha udhëheqjet e tyre aktive në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në të cilat janë të angazhuar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, që, në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe strukturat përkatëse administrative, të depozitojë aplikimin elektronik për kuotat, së bashku me dokumentacionin sipas Shtojcës nr. 4 të udhëzimit përkatës, brenda datës 31 korrik 2025, në platformën e-Albania.

4. Ky vendim i bashkëlidhet dokumentacionit zyrtar që i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për miratim përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare.

KRYETARI
PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1251 Prot.

Gjirokastrë më, 07.08.2025

VENDIM

Nr. 35, datë 07.08.2025

PËR

MIRATIMIN PARAPRAKISHT TË PROJEKT-BUXHETIT AFATMESËM 2026–2028

Në mbështetje të Nenit 38, gërma (h) të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; Ligjit Nr. 115/2024 "Për Buxhetin e Vitit 2025"; VKM nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026"; Udhëzimit nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; Udhëzimit të MASR për përgatitjen e projekt-buxhetit afatmesëm 2026–2028; Si dhe mbi bazën e relacionit shoqërues të Administratorit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë mbi projekt-buxhetin për periudhën 2026–2028. Senati Akademik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur.

VENDOSI:

1. Të miratojë Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2026–2028 të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Përbërja dhe struktura e projekt-buxhetit afatmesëm 2026–2028 përcaktohen sipas relacionit dhe tabelave shoqëruese, përfshirë fondet nga granti i buxhetit të shtetit dhe të ardhurat dytësore të institucionit, të ndara sipas zërave: paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative, investime, bursa dhe veprimtari akademike e kërkimore.
3. Në mbështetje të nenit 49, shkronja c të Ligjit nr. 80/2015, ky vendim i Senatit Akademik i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit "Eqrem Çabej" për miratim përfundimtar të projekt-buxhetit afatmesëm 2026–2028.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit që të ndjekë procedurat përkatëse për dërgimin dhe miratimin e projekt-buxhetit pranë autoriteteve përgjegjëse (MAS dhe Ministrisë së Financave), sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1315 Prot.

Gjirokastër, më 09.09.2025

V E N D I M

Nr. 36, datë 09.09.2025

**MIRATIMI I NJË ELEMENTI SHITESË NË FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E
DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË CIKLIN E DYTË
MASTER I SHKENCAVE NË "FINANCË - KONTABILITET"**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91, *udhëzimit nr. 14, datë 21.06.2022* "Për përcaktimin e elementëve përbërës të diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar, *udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020*, "Për përcaktimin e elementëve përbërës të diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" Kreu II dhe Kreu III, pika 2, *udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2025* për "Disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" dhe në zbatim të *Urdhërit të MASR nr. 330, datë 17.09.2021* për "Hapjen e programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave Financë Kontabilitet" në Universitetin "Eqrem Çabej, dhe në përgjigje të shkresës së QSHA-së, nr. 2207/1 datë 31.07.2025, pasi shqyrtoi dhe diskutoi formatin dhe përmbajtjen e diplomës për këtë program studimi, në mbledhjen e tij të datës, 09.09.2025;

VENDOSI:

1. Të miratojë formën dhe përmbajtjen e diplomës së re për programin e studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave në "Financë – Kontabilitet " me 120 ECTS, duke shtuar elementin "Emri dhe Mbiemri i Rektorit dhe Drejtuesit të njësisë kryesore, plotësohen me shtypshkrimi, dhe firma e Rektorit dhe Drejtuesit të njësisë kryesore plotësohen me shkrim dore".
2. Formati i diplomës i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1316 Prot.

Gjirokastrë, më 09/09/2025

V E N D I M

Nr. 37, datë 09.09.2025

**MIRATIMI I NJË ELEMENTI SHITESË NË FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E
DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË CIKLIN E DYTË
MASTER PROFESIONAL NË "MËSUES NË ARSIMIN SPECIAL"**

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91, *udhëzimit nr. 14, datë 21.06.2022* "Për përcaktimin e elementëve përbërës të diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar, *udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020*, "Për përcaktimin e elementëve përbërës të diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" Kreu II dhe Kreu III, pika 2, *udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2025* për "Disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" dhe në zbatim të *urdhërit të MAS nr. 526, datë 09.08.2022* për "Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga Master Profesional në Mësues Ndihmës në Edukimin Gjithëpërfshirës në Master Profesional në Mësues në Arsimin Special, pika 4, Universitetit "Eqrem Çabej, dhe në përgjigje të shkresës së QSHA-së, nr. 1217/4, pasi shqyrtoi dhe diskutoi formatin dhe përmbajtjen e diplomës për këtë program studimi, në mbledhjen e tij të datës, 09.09.2025;

VENDOSI:

1. Të miratojë formën dhe përmbajtjen e diplomës së re për programin e studimit në ciklin e dytë Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” me 120 ECTS, duke shtuar elementin “Emri dhe Mbiemri i Rektorit dhe Drejtuesit të njësisë kryesore, plotësohen me shtypshkrimi, dhe firma e Rektorit dhe Drejtuesit të njësisë kryesore plotësohen me shkrim dore”.
2. Formati i diplomës i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr JAHOCABA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 1317 Prot.

Gjirokastrë më, 09.09.2025

V E N D I M

Nr. 38, datë 09, 09, 2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE CGC UNIVERSITY,
MOHALI, PUNJAB, INDIA**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar memorandumit të mirëkuptimit me përfaqësues Prof. Dr. Anish Gupta Drejtor Akademik, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 09.09.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Cgc University, Mohali, Punjab, India sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1318 Prot.

Gjirokastrë më, 09.09.2025

V E N D I M

Nr. 39, datë 09.09.2025

P Ë R

**PËRFSHIRJEN E MODULIT ME TEMË "KOMPETENCAT NDËRKULTURORE PËR
PROFESIONISTËT E SHËNDETIT MJEKËSOR NË BALLKANIN PERËNDIMOR" NË
PROGRAMET E OFRUARA NGA DEPARTAMENTI I INFERMIERISË NË KUADËR
TË PROJEKTIT "TCCWB", FINANCUAR NGA PROGRAMI ERASMUS+ DHE
BASHKIMI EVROPIAN**

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës 09.09.2025 pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga ZV/ Rektor për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin shkencor me shkresën nr.1260 prot, datë 29.08.2025 mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3 pika 4, neni 36 pika 1, gërma (dh), Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19 në mbledhjen e Senatit Akademik, Rregulloren e brendshme të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Objektivat e projektit ndërkombëtar "TCCWB – Mbështetja e zhvillimit të kompetencave ndërkulturore për profesionistët e kujdesit shëndetësor në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga Programi Erasmus+ dhe Bashkimi Evropian;

V E N D O S I:

1. Miratohet përfshirja e modulit me temë "Kompetencat ndërkulturore për profesionistët e shëndetit mjekësor në Ballkanin Perëndimor" si cikël leksionesh për studentët e vitit të parë brenda lëndës "Bazat e Infermieristikës" në semestrin e dytë të programit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".
2. Përveç integritimit në kurrikulë, në kuadër të projektit TCCWB do të organizohen:
 - a) Trajnime të dedikuara për studentët dhe profesionistët e fushës së shëndetësisë;
 - b) Një shkollë dimërore, me pjesëmarrjen e studentëve, stafit akademik dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor, sipas planit të projektit dhe kërkesave të Erasmus+.
3. Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Infermierisë ngarkohen me:
 - përshtatjen e syllabus-it të lëndës "Bazat e Infermieristikës" me përfshirjen e ciklit të leksioneve;

- përgatitjen e planit të detajuar të trajnimeve dhe shkollës dimërore;
 - koordinimin me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor për zbatimin dhe raportimin sipas standardeve të Bashkimit Evropian.
4. Ngarkohen Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Kordinatori i Projektit TCCWB dhe për pasqyrimin e ndryshimeve dhe aktiviteteve përkatëse në dokumentacionin akademik dhe administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CADAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1365 Prot.

Gjirokastrë më, 17.09.2025

V E N D I M

Nr. 40 , datë 17 , 09 , 2025

P Ë R

**MIRATIMIN E ELEMENTEVE TË SIGURISË SË FORMËS SË DIPLOMAVE TË
LËSHUARA NGA UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor"; Propozimin e Komisionit të ngritur me Urdhrin e Rektorit nr. 118, datë 12.09.2025, për përcaktimin e elementeve të sigurisë; Senati Akademik, pas shqyrtimit të procesverbaleve më nr.1347/1 dhe 1347/2 të datës 12.09.2025, në mbledhjen e datës 17.09.2025:

V E N D O S I:

1. Të miratohen elementet e sigurisë së formës së diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, të cilat përfshijnë masa teknike, fizike dhe digjitale, në përputhje me dispozitat e Udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020, si dhe me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së dokumenteve zyrtare, me qëllim garantimin e vlefshmërisë, integritetit dhe mbrojtjes së tyre nga falsifikimi apo përdorimi i paligjshëm.
2. Elementet e sigurisë përfshijnë, ndër të tjera, përdorimin e letër-speciale sigurie, elementeve të personalizuar grafike, shenjave të verifikimit optik dhe elektronik, numërimit unik dhe

regjistrimit në sistemin kombëtar të diplomave dhe certifikatave, të cilat përcaktohen me akte të brendshme të administratës së Universitetit dhe në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Ngarkohet Administratori i Universitetit për zbatimin e këtij vendimi, duke siguruar përgatitjen dhe përdorimin e formave të diplomave dhe certifikatave vetëm sipas elementeve të miratuara të sigurisë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1405 Prot.

Gjirokastrë më, 26.09.2025

V E N D I M

Nr. 41, datë 26.09.2025

P Ë R

MIRATIMIN E PROPOZIMEVE PËR PERSONEL AKADEMIK NË FAKULTETE

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma ç, neni 57 e neni 62, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 51, neni 52, referuar shkresës nr.156 prot, datë 25.09.2025 "Përcillen propozime..." të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, shkresës nr.118 prot, datë 25.09.2025 "Propozim për numrin e personelit akademik...", të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, shkresës nr.100 prot, datë 24.09.2025 "dërgohet informacion për personel akademik..." të Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 26.09.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - 10 (dhjetë) të ftuar
2. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - 7 (shtatë) vende të lira pune
3. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimëdhënies, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - 1 (një) të ftuar
4. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimëdhënies, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - 7 (shtatë) vende të lira pune
5. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësië Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
 - 2 (dy) të ftuar me kohë të pjesshme

6. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës
 - 5 (pesë) vende të lira pune
7. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës:
 - 1 (një) të ftuar
8. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
 - 4 (katër) vende të lira pune
9. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Infermierisë, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
 - 11 (njëmdhjetë) vende të lira pune
10. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Infermierisë, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
 - 3 (tre) të ftuar
11. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Kontabilitet-Financës, pranë Fakultetin Ekonomik.
 - 3 (tre) të ftuar
12. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Kontabilitet-Financës, pranë Fakultetin Ekonomik.
 - 8 (tetë) vende të lira pune
13. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Administrimit Publik, pranë Fakultetin Ekonomik.
 - 3 (tre) të ftuar
14. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Administrimit Publik, pranë Fakultetin Ekonomik.
 - 8 (tetë) vende të lira pune
15. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, pranë Fakultetin Ekonomik.
 - 2 (dy) të ftuar
16. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, pranë Fakultetin Ekonomik.
 - 4 (katër) vende të lira pune
17. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bordi i Administrimit, Administratori, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

KRYETARI
PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1406 Prot.

Gjirokastrë më, 26 09 .2025

V E N D I M

Nr. 42 , datë 26 , 09 , 2025

P Ë R
NJË NDRYSHIMIN NË STRUKTURËN E UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni 3, pika 1, neni 38, pika ç, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 7, VKM nr. 325, datë 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve"; Vendimit të Senatit Akademik nr. 10, datë 06.02.2025; Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 02, datë 14.02.2025, Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit e Lartë" me propozim të Rektorit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Senatit Akademik i mbledhur sot në datë 26.09.2025:

V E N D O S I:

1. Të miratohet kërkesa për një ndryshimi në strukturën ndihmës akademike me karakter administrative të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, sipas propozimit të rektorit duke:
 - Pakësuar një (1) punonjës nga pozicioni "Punonjës informacioni/Sporteliste" në varësi të Administratorit;
 - Shtuar një (1) punonjës në Sektorin Juridik dhe të Burimeve Njerëzore, pranë Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore me pozicion "Specialist i burimeve njerëzore".
2. Ky ndryshim të reflektohet në strukturën organike dhe tabelën e pagave të Universitetit, si dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1500 Prot.

Gjirokastër më, 07.10.2025

V E N D I M

Nr. 43, datë 07.10.2025

P Ë R

MIRATIMIN E AMENDIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, neni 38, pika 1, gërma ç, Udhëzimin nr. 27, datë 27.06.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e strukturës dhe organizimit të institucioneve publike të arsimit të lartë"; Dhe në zbatim të kompetencave të Senatit Akademik si organi më i lartë kolegjal akademik i institucionit të arsimit të lartë publik,

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbledhjen e datës 07.10.2025, pasi u njoh me: Shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 3474/1prot, date 04.08.2025, "Për përshtatjen e Statutit të Universitetit 'Eqrem Çabej' Gjirokastër me kuadrin ligjor në fuqi dhe rekomandimet e MAS"; Urdhrin e Rektorit nr. 318, datë 13.09.2025, "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për hartimin e amendimeve statutore"; Relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Posaçëm për rishikimin e Statutit nr.1363/1, datë 01.10.2025;

V E N D O S I:

1. Të miratojë amendimet në Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, të hartuara në zbatim të shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas versionit të bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Amendimet e miratuara së bashku me dokumentacionin (vendimet BA & SA + statuti i konsoliduar) do të ngarkohet në e-Albania për miratim përfundimtar.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI
PROF. DR JAHO ÇANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1502 Prot.

Gjirokastrë, më 07 / 10 / 2025

VENDIM

Nr. 44 , datë 07 . 10 . 2025

PËR

**MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË KUOTAVE TË LIRA NË PROGRAMET E
STUDIMIT TË CIKLIT E DYTË NË FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE SHKENCAVE
SHOQËRORE PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në ligjin 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 76, Udhëzimin nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar, Urdhërin e Përbashkët të QSHA dhe Qendrës Ndërinstitucionale Rrjetit Akademik Shqiptar nr. 157, datë 03.06.2025 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 66, Vendimit të Senatit Akademik nr 17, datë 21.03.2025, "Për miratimin e kuotave për vitin akademik 2025-2026, për programet e studimit që ofron Ugj" si dhe pas propozimit të Drejtorisë së Kurrikulave, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, me shkresën Nr. 1487 prot, datë 06.10.2025, Senati Akademik i Ugj-së, në mbledhjen e tij të datës, 07.10.2025, pasi diskutoi rreth procesit të aplikimeve për pranimet në ciklin e dytë të studimeve:

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e kuotave të lira për disa në programet e studimit të ciklit të dytë:
 - a. Në programin e studimit të ciklit të dytë, **Master Profesional në Mësuesi në Arsimin Fillor**, transferohet kuotat e paplotësuara të kategorive të veçanta. Gjithashu në këtë program studimi transferohen kuotat e pa realizuara të programit të studimit **Master Profesional në Mësuesi në Arsim Fillor në Gjuhën Greke**.
 - b. Në programin e studimit të ciklit të dytë, **Master Profesional në Mësuesi në Arsimin Special**, transferohet kuotat e paplotësuara të kategorive të veçanta. Gjithashu në këtë program studimi transferohen kuotat e pa realizuara të programit të studimit **Master i Shkencave në Matematikë – Fizikë**.

- c. Në programin e studimit të ciklit të dytë, **Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike**, transferohet kuotat e paplotësuara të kategorive të veçanta. Gjithashu në këtë program studimi transferohen kuotat e pa realizuara të programit të studimit **Master i Shkencave në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC** (program i përbashkët). Këtij vendimi do ti bashkëlidhet shtojca 1 e kuotave totale.
2. Transferimi i kuotave të lira kryhet vetëm brenda programeve të studimit të ciklit të dytë në të njëjtin fakultet dhe nuk ndryshon numrin total të kuotave të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për Universitetin “Eqrem Çabej” për vitin akademik 2025–2026.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet si dokument shoqërues kërkesës zyrtare për miratim të transferimeve të kuotave, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 12/2023.”

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Jahir CANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 1503 Prot.

Gjirokastrë më, 07.10.2025

V E N D I M

Nr. 45, datë 07.10.2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE INSTITUTIT TË
SISTEMEVE TË SOFTUERVE TË AKADEMISË KOMBËTARE TË SHKENCAVE TË
UKRAINËS**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar memorandumit të mirëkuptimit i përfaqësuar nga Drejtori Igor SINITSYN, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 07.10.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Institutit të Sistemeve të Softuerve të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Ukrainës sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO ÇANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1504 Prot.

Gjirokastrë më, 07.10.2025

V E N D I M

Nr. 46, datë 07, 10, 2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT
TEKNIK KOMBËTAR TË UKRAINËS "INSTITUTI POLITEKNIK I KIEVIT IGOR
SIKORSKY"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar memorandumit të mirëkuptimit me Numër Reference M/26.03/67/25 i përfaqësuar nga Rektori Anatolii MENYCHENKO, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 07.10.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Universitetit Teknik Kombëtar të Ukrainës "Instituti Politeknik i Kievit Igor Sikorsky" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHOR CANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1505 Prot.

Gjirokastrë më, 07.10.2025

V E N D I M

Nr. 44, datë 07, 10, 2025

P Ë R

**SHPALLJEN E VAKANCËS SË NJË VENDI NË BORDIN E ADMINISTRIMIT DHE
NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E KANDIDATURAVE**

Në mbështetje të Nenit 38, pika 1, gërma gj të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Nenit 18, 19 pika 5 dhe neni 20 pika 7, shkronja "c" të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Rregullores së brendshme të Senatit Akademik neni 6, pika 19;

Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 07.10.2025, pasi u njoh me njoftimin e Rektorit mbi daljen në pension pleqërie të znj. Majlinda Bobrati, anëtare e Bordit të Administrimit dhe përfaqësuese e personelit akademik, dhe pasi konstatoi se kjo sjell mbarimin e mandatit sipas nenit 20, pika 7, shkronja "c" të Statutit,

V E N D O S I:

1. Të shpallet vakant vendi i një anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, përfaqësues i personelit akademik, për shkak të përfundimit të mandatit si pasojë e daljes në pension të znj. Majlinda Bobrati.
2. Të ngrihet një komision ad-hoc me këtë përbërje:

a) Prof. Asoc Sadik Malo	Kryetar
b) Borana Lelaj (Jurist)	Antarë
c) Briseda Kamemaj	Antarë
3. Komisioni ka për detyrë të verifikojë dokumentacionin e kandidatëve dhe përmbushjen e kritereve ligjore dhe statutore, duke përgatitur listën përfundimtare të kandidaturave për votim në Senatin Akademik.
4. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:
 - Të jenë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin "Eqrem Çabej";

- Të kenë eksperiencë akademike dhe institucionale;
- Kandidati duhet të zotërojë titullin shkencor “Doktor i Shkencave”, të fituar pranë një institucioni të arsimit të lartë të akredituar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në rast se titulli është fituar jashtë vendit, ai duhet të jetë njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin e Lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për njohjen dhe vlerësimin e diplomave të huaja.
- Të mos kenë masa disiplinore aktive;
- Të mos kenë pengesa të tjera ligjore ose statutore për ushtrimin e funksionit.

5. Dokumentacioni i aplikimit

- Kërkesë për kandidim;
 - Curriculum Vitae;
 - Kopje të diplomave dhe titujve akademikë;
 - Vërtetim nga Sektori i Burimeve Njerëzore për statusin si personel akademik me kohë të plotë;
 - Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve ligjore dhe statutore.
6. Dokumentacioni i plotë të dorëzohet pranë Zyrës së Asistentes së Rektorit brenda **5 (pesë) ditëve kalendarike** nga data e shpalljes së këtij urdhri, në orarin 09:00 – 12:00.

Pas përfundimit të afatit, Komisioni do të verifikojë kandidaturat dhe do të paraqesë listën përfundimtare për miratim në Senatin Akademik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. JAHO CASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1506 Prot.

Gjirokastrë, më 07.10.2025

V E N D I M

Nr. 48, datë 07.10.2025

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 34, DATË 25.07.2025, "PËR MIRATIMIN E
PROJEKTEVE KËRKIMORE - SHKENCORE DHE ZHVILLIMIT NË PROGRAMIN E
PËRBASHKËT TË STUDIMIT NË CIKLIN E TRETË
DOKTORATË NË "EDUKIM DHE SHKENCA HUMANE" MIDIS UGJ-SË DHE UMP-
GREQI**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" i ndryshuar", Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar dhe përditësuar, dhe në mbështetje të Urdhërit të MAS-it, Nr. 362, datë 12.07.2024, me nr 4500/1 prot, datë 12.07.2024, me subjekt për "Hapjen e programit të përbashkët në ciklin të tretë të studimeve Doktoratë në "Edukim dhe Shkenca Humane", midis Universitetit "Eqrem Çabej", aplikimit të përcjellë nga ana jonë me shkresën Nr. 1236 prot, datë 28.07.2025, për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për këtë program studimi (bashkëlidhur shtojca nr. 4 dhe Vendimi i Senatit Akademik nr.34, datë 25.07.2025), Senati Akademik i UGj-së, në bashkëpunim dhe me partnerët tanë në Universitetin e Maqedonisë Perëndimore- Greqi, pasi diskutuan për projektet kërkimore- shkencore dhe zhvillimit dhe bashkëudhëheqësit sipas fushave të të dy universiteteve, në mbledhjen e datës 07.10.2025;

V E N D O S I:

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin Nr. 34, datë 25.07.2025 të Senatit Akademik të UGj-së.
2. Miratimin e 10 projekteve kërkimore – shkencore dhe zhvillimit me bashkëudhëheqës nga të dy Universitetet partnere përkatësisht UGj dhe UMP-Greqi, sipas shtojcës bashkëlidhur.

3. Ridërgimin e shtojcës nr. 4, Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar dhe përditësuar, me 10 projektet e përditësuara për vitin akademik 2025-2026.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit për verifikim të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për programin e përbashkët në ciklin e tretë.

KRYETARI

PROF. DR. JAHOCANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1591 Prot.

Gjirokastrë më, 14.10.2025

V E N D I M

Nr. 49, datë 14, 10, 2025

P Ë R

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË KRITERIT TË PRANIMIT TË NOTËS MESATARE
PËR STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE "MASTER I SHKENCAVE
NË ARKEOLOGJI DHE ADMINISTRIM TË PASURIVE ARKEOLOGJIKE", PËR
VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të: Nenit 38, pika 1, shkronja "a", të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Nenit 18 dhe 19 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Rregullores së Senatit Akademik, Vendimit të Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore nr. 13, datë 13.10.2025, "Për miratimin e ndryshimit të vendimit nr. 1, datë 16.01.2024, prot. 05, lidhur me kriteret e pranimit të notës mesatare për studentët e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në 'Arkeologji dhe Administrim të Pasurive Arkeologjike' për vitin akademik 2025-2026"; Duke u njohur me relacionin shoqërues të Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe me diskutimet e anëtarëve të Senatit Akademik në mbledhjen e datës 15.10.2025;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e vendimit nr. 1, datë 16.01.2024, në përputhje me vendimin nr. 13, datë 13.10.2025, të Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, lidhur me kriteret e pranimit të notës mesatare për studentët e ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave në Arkeologji dhe Administrim të Pasurive Arkeologjike", për vitin akademik 2025-2026.
2. Të përcaktojë se nota mesatare minimale e pranueshme për aplikantët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve (Bachelor), dhe që kërkojnë të ndjekin programin e mësipërm të ciklit të dytë, të jetë ≥ 6.5 (gjashtë pikë pesë).
3. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore, dhe Komisionin e Posaçëm për Regjistrim të reflektojë menjëherë ndryshimin në dosjet orientuese të pranimit dhe në njoftimet zyrtare për kandidatët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për zbatim Dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe publikohet në faqen zyrtare të universitetit.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr 1592 Prot.

Gjirokastrë më, 14.10.2025

V E N D I M

Nr. 50, datë 14.10.2025

P Ë R

**SHPLLJEN E FITUESIT TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË
PËRFAQËSUESIT TË PERSONELIT AKADEMIK NË BORDIN E ADMINISTRIMIT**

Në mbështetje të Nenit 38, pika 1, gërma "gj" të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Nenit 18, 19 pika 5 dhe Nenit 20 pika 7, shkronja "c" të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; si dhe në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik nr. 47, datë 07.10.2025, "Për shpalljen e vakancës së një vendi në Bordin e Administrimit dhe ngritjen e komisionit për verifikimin e kandidaturave";

Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2025, pasi u njoh me raportin përfundimtar të Komisionit ad-hoc të ngritur me vendimin e sipërcituar, mbi përfundimin e verifikimit të dokumentacionit dhe procesit të votimit për përzgjedhjen e përfaqësuesit të personelit akademik në Bordin e Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të shpallet fituesi i procedurës së përzgjedhjes së përfaqësuesit të personelit akademik në Bordin e Administrimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Dr. Dhori Terpo.
2. Fituesi do të përfaqësojë personelin akademik në përbërjen e Bordit të Administrimit, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe kuadrin ligjor në fuqi.
3. Sekretaria teknike ngarkohet për njoftimin e këtij vendimi pranë Bordit të Administrimit dhe për publikimin e tij në faqen zyrtare të universitetit dhe në ambientet e dukshme të institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHO CANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1884 Prot.

Gjirokastër më, 11/11.2025

V E N D I M

Nr. 51, datë 11/11/2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT ËT MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT
PIEMONTE ORIENTALE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar kërkesës për bashkëpunim të Universitetit Piemonte Orientale, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 11.11.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster dhe Universitetit Piemonte Orientale sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHOR CAJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1885 Prot.

Gjirokastrë më, 11.11.2025

V E N D I M

Nr. 52, datë 11.11.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E FORMALIZIMIT TË RRJETIT TË STUDENTËVE ERASMUS (ESN)
PRANË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 1, gërma e, neni 2, gërma dh, neni 3, neni 36, pika 1, neni 37, neni 38, Ligjit nr. 117/2014, datë 11.09.2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Erasmus +", programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; i ndryshuar; Kartës Erasmus për Arsimin e Lartë (Erasmus Charter for Higher Education – ECHE 2021–2027), Udhëzuesi i Programit Erasmus+ i Komisionit Evropian, në përputhje me nenet 165 dhe 166 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), që përcaktojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në arsim, kërkim dhe inovacion; Kërkesës nr. 1620 prot., datë 17.10.2025, paraqitur nga Sektori i Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, për formalizimin e Rrjetit të Studentëve Erasmus (ESN) në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; Senati Akademik në mbledhjen e të datës 11.11.2025;

VENDOSI:

1. Të miratojë formalizimin e Rrjetit të Studentëve Erasmus (Erasmus Student Network – ESN) si një strukturë studentore që vepron pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, nën mbështetjen institucionale të Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.
2. Ngarkohet Zv/Rektor për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor, në bashkëpunim me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik, dhe i komunikohet të gjithë strukturave përkatëse për dijeni.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1886 Prot.

Gjirokastrë më, 11.11.2025

V E N D I M

Nr. 53, datë 11.11.2025

PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMEVE PËR PERSONEL AKADEMIK NË FAKULTETE

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma ç, neni 57 e neni 62, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 51, neni 52, referuar shkresës nr.187/1 prot, datë 04.11.2025 "Përcillen propozime..." të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, shkresës nr.146/prot, datë 04.11.2025 "Propozim për numrin e personelit akademik...", shkresës nr.149/1prot, datë 01.11.2025 të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, shkresës nr.190 prot, datë 07.11.2025 "Dërgohet informacion për personel akademik..." të Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 11.11.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimëdhënies, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - 2 (dy) vende të lira pune
2. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Gjuhëve të Huaja, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - 1 (një) vend të lirë pune
3. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësië Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
 - 1 (një) vend të lirë pune
4. Miratimin e propozimit për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës
 - 1 (një) vend të lirë pune
5. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Infermierisë, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

- 3 (tre) të ftuar
- 6. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Kontabilitet-Financës, pranë Fakultetin Ekonomik.
 - 2 (dy) të ftuar
- 7. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Administrimit Publik, pranë Fakultetin Ekonomik.
 - 1 (një) të ftuar
- 8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bordi i Administrimit, Administratori, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO ÇABA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1884 prot.

Gjirokastrë, më 11 . 11 . 2025

VENDIM

Nr. 54, datë 11.11 2024

PËR

**MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË STUDENTËVE TË REGJISTRUAR PËR
VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË,
CIKLIT TË DYTË, PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL DHE PROGRAMIT
TË FORMIMIT TË VASHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE QË OFRON
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**

Në mbështetje të ligjit, nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 3 e nenit 33, pika 3 e nenit 69, në zbatim të udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, Urdhërit të Përbashkët të QSHA dhe Qendrës Ndërinstitucionale Rrjetit Akademik Shqiptar, nr. 157, datë 03.06.2025 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026, si dhe urdhërit nr. 221, datë 29.10.2025 "Për disa ndryshime në urdhërin nr 157, datë 03.06.2025, Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026.", VKM-së nr 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 11.11.2025, pas përfundimit të procesit të regjistrimeve për vitin akademik 2025-2026, në ciklin e parë, ciklin e dytë, programet me karakter profesional dhe programin e formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike, diskutoi numrin e të regjistruarve për çdo program studimi dhe;

VENDOSI ;

1. Të miratojë numrin total të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të parë, programeve me karakter profesional dhe programeve të ciklit të dytë dhe programit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë funksionimin për këtë vit akademik të programit në ciklit të dytë "Master" (në fushën e mësuësise) në Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, i cili ka një numër më të ulët 6 (gjashtë) të regjistruar për vitin 2025-2026, se numri minimal 10 (dhjetë) për hapjen e një programi studimi.

Të regjistruarve për këtë vit akademik u shtohet edhe numri i studentëve sipas kategorisë si mëposhtë :

- a. Studentë përsëritës për vitin e parë,

Nevoja dhe miratimi për hapjen e këtij programi vjen si rrjedhojë, pasi ky program studimi ka specifika të veçanta, ku fokus grup janë mësuesit e gjuhës greke për minoritetit etnik grek, të cilët janë të angazhuar në arsimin parauniversitar në rajonin jugor dhe nevoja për mësues të kualifikuar është e lartë.

3. Miraton shpalljen jo aktive të programit të ciklit të parë "Bachelor" në Matematikë Informatikë, "Master i Shkencave" në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Kulturore- ASPIC", "Master i Shkencave" në mësuesi në Matematikë – Fizikë dhe "Master Profesional" në mësues për Arsimin Fillor në gjuhën greke, për arsye të mos regjistrimit të asnjë studenti në këto programe studimi.
4. Shtojcat për regjistrimet në programet e ciklit të parë, programeve me karakter profesional dhe programeve të ciklit të dytë i bashkëlidhen këtij vendimi.
5. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit njohje dhe miratim të numrit të përgjithshëm të studentëve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UGJ-së .

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1888 Prot.

Gjirokastrë më, 11 . 11 . 2025

V E N D I M

Nr . 55 , datë 11 , 11 , 2025

PËR
MIRATIMIN E NGRITJES SË GRUPIT MËSIMOR SI STRUKTURË EKUIVALENTE
NË NIVEL FAKULTETI EKONOMIK

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", veçanërisht: Nenin 3, pika 2, gërma a, pika 4, gërma a, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 318, datë 13.09.2021, neni 7, pika 2, gërma b, neni 10, pika 3, neni 19, Rregulloren e Universitetit "Eqrem Çabej", miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 48, datë 26.10.2023, Propozimin e Dekanit të Fakultetit Ekonomik, Prof. Asoc. Lorenc Koçiu, me shkresën nr. 176 Prot., datë 29.10.2025, drejtuar Rektorit dhe Senatit Akademik, ku kërkohet miratimi për ngritjen e një Grupi Mësimor në nivel fakulteti, me argumentimin se aktualisht:

- Në Fakultetin Ekonomik nuk funksionon asnjë grup mësimor në nivel departamenti;
- Disa departamente nuk përmbushin strukturën minimale ligjore për ngritjen e grupit (numrin 10 të anëtarëve sipas Ligjit 80/2015);
- Nuk ekziston ndalim ligjor për ngritjen e një grupi mësimor në nivel fakulteti;
- Nevoja për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për koordinimin akademik kërkon një zgjidhje organizative në nivel fakulteti.

Senati Akademik, pasi shqyrtoi propozimin e Dekanit të Fakultetit Ekonomik, analizoi bazën ligjore dhe statutore, si dhe nevojën institucionale për garantimin e procesit mësimor,

V E N D O S I:

1. Të miratohet ngritja e Grupit Mësimor në nivel Fakulteti Ekonomik të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si strukturë e përkohshme akademike, me karakter organizativ dhe koordinues, për periudhën deri në krijimin e grupeve mësimore në nivel departamenti.
2. Grupi Mësimor në nivel fakulteti do të ketë këto qëllime kryesore:

- a) Planifikimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik në bashkërendim me departamentet;
 - b) Koordinimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore në nivel fakulteti;
 - c) Sigurimin e vijimësisë së procesit mësimor në mungesë të grupeve mësimore departamentale;
 - d) Hartimin e propozimeve për përmirësimin e strukturës mësimore dhe raportimin periodik.
3. Ky grup nuk zëvendëson departamentet ekzistuese dhe nuk ndryshon strukturën themelore të njësive bazë, por vepron si strukturë ndihmëse për mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike dhe realizimin e objektivave të Fakultetit Ekonomik.
4. Ngarkohet Bordi i Administrimit për miratim si dhe Dekani i Fakultetit Ekonomik, për hartimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Grupit Mësimor, e cila përcakton përbërjen, mandatet, detyrat dhe mënyrën e raportimit, që i paraqitet Senatit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CAXA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1961 Prot.

Gjirokastrë më, 20.11.2025

V E N D I M

Nr. 56, datë 20, 11, 2025

P Ë R

MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT (DIPLOMË E DYFISHTË)
"BACHELOR NË INFERMIERISTIKË"
MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR DHE UNIVERSITETIT
TË PIEMONTE, ITALI

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 73 e neni 80; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, të ndryshuar"; VKM nr. 823, datë 28.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41/2018"; Udhezimit nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; Rregullores së brendshme të UGJ-së; si dhe mbështetur në Vendimin nr. 5, datë 30.10.2025 të Njesisë Bazë të Infermierisë për miratimin e hapjes së programit të ri të përbashkët (diplomë e dyfishtë) "Bachelor në Infermieristikë", Shkresën e Njesisë Bazë të Infermierisë nr. 144/2, datë 03.11.2025, me propozimin për hapjen e programit të ri dhe dokumentacionin përkatës, Vendimin nr. 06, datë 18.11.2025 të Këshillit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës për miratimin e hapjes së programit të përbashkët dhe planit mësimor, Shkresën përcjellëse të Fakultetit nr. 153 Prot., datë 18.11.2025, për Rektorin e Universitetit, Propozimin për kodifikimin e programit të ri me kodin **63BA0913SAI**, referuar shkresës së Njesisë Bazë të Infermierisë datë 30.10.2025, Dokumentacionin shoqërues të fazës së parë, të përgatitur sipas udhëzimit nr. 1/2020, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë në mbledhjen e datës 20.11.2025,

V E N D O S I :

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët (diplomë e dyfishtë) "Bachelor në Infermieristikë", midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Universitetit të Piemonte – Itali, në ciklin e parë të studimeve.

2. Të miratojë planin mësimor të programit, me kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS, dhe ofrimin e tij në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze, sipas dokumentacionit të parashtruar nga Njësia Bazë e Infermierisë dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës.
3. Të miratojë kodifikimin e programit të përbashkët të studimit me **kodin: 63BA0913SAI**, sipas propozimit të Njesisë Bazë të Infermierisë dhe në përputhje me udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022 "Për procedurat e kodifikimit të programeve të studimit".
4. Të miratojë dokumentacionin e fazës së parë për hapjen e programit, i hartuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimit nr. 1/2020 të MAS.
5. Ngarkohet Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej" për ndjekjen e procedurave të mëtejshme pranë MAS dhe institucioneve të tjera për miratimin përfundimtar të programit të përbashkët të studimit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI
PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1962 Prot.

Gjirokastrë më 20.11.2025

V E N D I M

Nr. 57, datë 20, 11, 2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË BASHKËPUNIMIT TË DREJTËPËRDREJTË
NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE ALEANCËS
SË GRUPIT TË MENDIMEVE KINË-CEE PËR BASHKËPUNIM NË INOVACION**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar kërkesës për bashkëpunim të aleancës së Grupit Inteligjent Kinë-CEE për Bashkëpunim në Inovacion, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 20.11.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin, në parim, të bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Aleancës së Grupit të Mendimeve Kinë-Cee për Bashkëpunim në Inovacion sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR. JAHOR ÇANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 1963 Prot.

Gjirokastrë më, 20.11.2025

V E N D I M

Nr. 58, datë 20.11.2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT
NDËRKOMBËTAR TË STUDIMEVE TË SHANGAIT, KINË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 20.11.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Universitetit Ndërkombëtar të Studimeve të Shangait sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2098 Prot.

Gjirokastrë, më 18/12/2025

VENDIM

Nr. 59, datë 18.12.2025

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË DETAJUAR VJETOR TË VEPRIMTARISË
MËSIMORE, SHKENCORE DHE FINANCIARE NË UNIVERSITETIN "EQREM
ÇABEJ" PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Në zbatim të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 32, neni 38 pika 1 gërmat "g" dhe "l"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 2/e dhe pika 8; udhëzimit të MAS nr. 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatet për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", ndryshuar me udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019; udhëzuesi nr. 75/3, datë 11.07.2023 "Për modelin e raportimit vjetor të institucioneve publike të arsimit të lartë, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, mbledhja e përbashkët e Senatit Akademik dhe e Bordit të Administrimit, datë 18.12.2025, pasi diskutoji mbi projektraportin e hartuar nga grupi i ngritur me urdhër të Rektorit nr. 179, datë 17.11.2025,

VENDOSI

1. Të miratoj raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë mësimore, shkencore dhe financiare të UGJ-së për vitin akademik 2024-2025;
2. Raporti i bashkëlidhet këtij vendimi;
3. Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare në Universitetin "Eqrem Çabej" për vitin akademik 2024-2025, i përcillet zyrtarisht MAS-it në format elektronik (PDF) dhe shkresor;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof. dr. Jaho CANA

Prof. dr. Merita ISARAJ



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 2099 Prot.

Gjirokastrë më, 18.12.2025

V E N D I M

Nr. 60, datë 18, 12, 2025

P Ë R

**MIRATIMIN E NGARKESËS MËSIMORE VJETORE TË PERSONELIT AKADEMIK
NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 59, pika 8, Vendimit Nr. 329, datë 12.04.2017 "Për Statusin dhe Trajtimin e Veçantë të Personelit Akademik", Udhëzim Nr. 29, Datë 10.09.2018 "Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë (ndryshuar me Udhëzimin Nr. 36, Datë 23.11.2018, Udhëzimin Nr.37, Datë 04.12.2018)". Senati Akademik në mbledhjen e të datës 18.12.2025.

V E N D O S I :

1. Miratimin, e ngarkesës mësimore vjetore të personelit akademik në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë për vitin akademik 2025-2026, sipas shkojçës bashkelidhur këtij vendimi.
2. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim dhe zbatim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO ÇABA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 2100 Prot.

Gjirokastrë më, 18.12.2025

V E N D I M

Nr. 61, datë 18, 12, 2025

PËR
TRANSFERIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; neni 3, pika 1, neni 38, pika ç, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 7, Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit e Lartë", Shkresës nr. 198 prot, date 05.12.2025, të Dekanatit të Fakultetit Ekonomik, me lëndë "Propozim për transferim të personelit akademik", Propozimit të Njesisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Fakulteti Ekonomik, datë 05.12.2025, Nevojave akademike dhe organizative të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Senatit Akademik i mbledhur sot në datë 18.12.2025:

V E N D O S I:

1. Miratimin e transferimit të personelit akademik Msc. Selaudin Mosho, nga Njësia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Fakulteti Ekonomik, pranë Njesisë Bazë të Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
2. Transferimi kryhet për arsye të riorganizimit dhe balancimit të burimeve njerëzore akademike, në funksion të përmbushjes së nevojave mësimore dhe kërkimore të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
3. Ngarkohen Rektori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe strukturat akademike përkatëse për zbatimin e këtij vendimi dhe kryerjen e të gjitha veprimeve administrative përkatëse.
4. Ky ndryshim të reflektohet në strukturën organike, si dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO ÇABA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK**

Nr 2101 Prot.

Gjirokastrë më, 18.12.2025

V E N D I M

Nr. 62, datë 18, 12, 2025

P Ë R

**MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT NDËRMJET
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT
TEKNIK TË ESKIŞEHIRIT, ESKIŞEHIR TURQI**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 3, gërma e, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 18.12.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë dhe Universitetit Teknik të Eskişehir, Eskişehir Turqi sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 2102. Prot.

Gjirokastrë më, 18.12.2025

V E N D I M

Nr. 63 , datë 18 , 12 , 2025

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMEVE PËR PERSONEL AKADEMIK TË FTUAR NË
FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma ç, neni 57 e neni 62, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 51, neni 52, referuar shkresës nr.191/1 prot, datë 10.11.2025 "Përcillen miratim i propozimit për personel akademik të ftuar." të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 18.12.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e propozimit për personel akademik të ftuar në Njësinë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
 - 1 (një) të ftuar
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bordi i Administrimit, Administratori, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2103 Prot.

Gjirokastrë më, 18.12.2025

V E N D I M

Nr. 64, datë 18, 12, 2025

P Ë R

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMIN E PËRBASHKËT ME
UNIVERSITETIN E MAQEDONISË PERËNDIMORE, NË CIKLIN E TRETË –
DOKTORATË NË EDUKIM DHE SHKENCA HUMANE**

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, neni 38, Statutit të UGJ-së, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë"; Udhëzimit nr. 10, datë 16.06.2023, për ndryshimin e Udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë"; Vendimit të Komisionit Institucional për Shkollën Doktorale të UGJ-së, datë 16.12.2025; Vendimit të Rektoratit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë nr.09, datë 17.12.2025, pas shqyrtimit të materialeve dhe diskutimit në mbledhjen e tij,

V E N D O S I :

1. **Miratimin e kriterëve të pranimit në programin e përbashkët me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore, në ciklin e tretë të studimeve – Doktoratë në Edukim dhe Shkenca Humane**, për vitin akademik 2025–2026, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Bordi i Administrimit për miratimin e këtij vendimi dhe njësitë përkatëse akademike dhe administrative për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI
PROF. DR. JAHORCANA

